

“Perandoria e Diellit” bazohet në përvojën time në Shangai, në Kinë, gjatë Luftës së Dytë Botërore, si dhe në Lunghua CAC (Civilian Assembly Centre), ku kam qenë i internuar gjatë viteve 1942-1945. Në pjesën më të madhe, ky roman bazohet në ngjarje që i kam vëzhguar gjatë pushtimit japonez të Shangait dhe brenda kampit Lunghua.

Sulmi japonez mbi *Përl Harbor* ndodhi mëngjesin e së dielës të 7 dhjetorit 1941, por, si rrjedhojë e ndryshimit kohor mes dy anëve të meridianit të datës të Paqësorit, në Shangai kishte gdhirë mëngjesi i së hënës, 8 dhjetor.

J. G. BALLARD



Në Shangai luftërat erdhën herët, duke ndjekur njëra-tjetrën ashtu si rrymat që i ngjiteshit përpjetë rrjedhës së lumit Jance, duke i kthyer këtij qyteti madhështor gjithë qivuret që hidheshin në lumë nga molet funerale të Bundit Kinez.

Xhimi kish filluar të shihte ëndrra me luftë. Natën, në muret e dhomës së tij të gjumit në Bulevardin Amherst i dukej sikur drithëronin po ata filma pa zë, që ia shndërronin mendjen e fjetur në një sallë të zbrazët, ku projektoheshin kinoditarë. Në dimrin e vitit 1941, gjithkund në Shangai shfaqeshin filma me luftë. Copëza nga këto ëndrra e ndiqnin Xhimin pas nëpër qytet; në sallat e qendrave tregtare dhe të hoteleve, kur befasi nga mendja e tij e tejmbushur shpërthenin pamje nga Tobruku e Dynkerku, nga Barbarosa apo Plaçkitja e Nankinit.

Xhimi u ndje keq kur pa se edhe Dekani i Katedrales së Shangait kishte marrë një aparat të vjetër projektimi. Mbas shërbesës së mëngjesit të së dielës së datës 7 dhjetor, në vigjilje të sulmit japonez mbi *Përl Harbor*, para se të largoheshin për në shtëpi, djemtë e korit i zbritën poshtë në kriptë. Ende të veshur me rasant e tyre, u ulën në një radhë shezlongjesh plazhi të marra nga Shanghai *Yacht Club*, dhe ndenjën të shihnin një nga kinoditaret ‘Ecuria e kohës’ të vitit të shkuar.

Me mendjen ende të ëndrrat e tij të turbullta, dhe i intriguar nga mungesa e kolonës zanore, Xhimi zuri të tërhiqte jakën me dantella. Muzika e organos regëtinte si një dhimbje koke, teksa përshkonte tavanin prej çimentoje, ndërsa ekrani dridhej me pamjet tashmë të njohura të betejave me tanke dhe të përleshjeve ajrore. Në të vërtetë, Xhimit mezi i pritej sa të ikte që andej, që të bëhej gati për festën me maska të Krishtlindjes, që do të organizonte atë pasdite doktor Lokvudi, nënkryetari i Shoqatës së Rezidentëve Britanikë. Për të shkuar aty do të kalonin përmes vijave japoneze, deri në Hungiao, pastaj kish për të parë pehllivanët

kinezë, fishekzjarret dhe prapë kinoditarë, po sidoqoftë Xhimi kishte arsyet e veta përse donte të shkonte në festën e doktor Lokvudit.

Përrjashta, përpara portës së sakristisë, shoferët kinezë që prisnin pranë veturave *Packard* dhe *Buick*, po diskutonin mes tyre plot zjarr. I mërzhitur nga filmi, të cilin e kishte parë nja dhjetë herë, Xhimi u vu të dëgjonte se si Jangu, shoferi i babait, po ngacmonte sakristanin australian. Sidoqoftë, parja e kinoditarëve ishte bërë për çdo britanik jashtë atdheut një detyrë po aq patriotike sa dhe lotaria për të mbledhur fonde, që organizonte *Country Club*. Nga ballot dhe mbrëmjet e argëtimit, si dhe shishet e panumërta me uiski që konsumoheshin në kësi rastesh për të dhënë ndihmën e tyre për shpenzimet e luftës (si gjithë kalamajtë, dhe Xhimi ishte kureshtar për alkoolin, pa çka se në një mënyrë të turbullt, ishte kundër tij), qenë mbledhur shpejt para të cilat mjaftonin për të blerë një aeroplan *Spitfire* - ndoshta një nga ata, mendoi Xhimi me vete, të rrëzuar qysh në betejën e parë, me pilotin e alivanosur mes avujve të *Johnnie Walker*-it.

Kinoditarët qenë pjesë e sforcos propagandistike të ambasadës britanike për t'iu kundërvënë filmave gjermanë dhe italianë me luftë, që projektoheshin nëpër kinematë publike dhe klubet e Boshtit në Shangai dhe, zakonisht, Xhimi i përpinte ato. Herë-herë, kinoditarët anglezë të prodhuar nga studioja Pathé, i krijonin përshtypjen se, në Angli, me gjithë vargun e pandërprerë të humbjeve, populli po kënaqej së tepërmi me luftën. Përkundrazi filmat e '*Ecurisë së kohës*' qenë më të zyrtë, prandaj dhe e tërhiqnin më shumë. Me rason e ngushtë që e shtrëngonte dhe po ia merrte frymën, Xhimi pa një aeroplan *Hurricane* në flakë mes një qielli të mbushur plot me bombardues Dornier, që po binte drejt një peizazhi plot me lëndina angleze si ato të librave për fëmijë, që në të vërtetë ai s'i kishte parë ndonjëherë. *Graf Spee* dergjej e mbytur në Rio de la Plata, një lumë po aq i trishtë sa dhe Janceja, ndërkohë që nga një qytet i rrënuar në Europën lindore, nga ai planet i zi nga ku para gjashtë muajsh kishte ikur me një anije refugjatësh Vera Frankeli, guvernantja e tij shtatëmbëdhjetë vjeçare, ngriheshin re tymi.

Më në fund filmi mbaroi dhe Xhimi mori frymë i lehtësuar. Bashkë me shokët dolën duke u kalamendur në dritën e çuditshme të asaj dite dhe shkuan drejt shoferëve të tyre. Patrik Makstedi, shoku i tij më i ngushtë, kishte ikur me anije bashkë me të ëmën nga Shangai, që të gjenin siguri në 'fortesën' britanike të Singaporit, ndaj dhe tani Xhimit i duhej t'i shihte filmat dhe për të, madje edhe për ato ruset e bardha që shisnin bizhuteritë e tyre te shkallët e katedrales, dhe lypsarët kinezë që pushonin mes varreve.

Zëri i komentatorit vazhdoi t'i gjëmonte brenda kokës, teksa po kthehej në shtëpi me *Packard*-in e prindërve përmes rrugëve të tejmbushura të Shangait. Jangu, shoferi me një të folur të rrëmbyer, që një herë kishte pasur rastin të punonte si figurant në një film vendas me protagoniste Çian Çinin, aktoren që e kish lënë karrierën për t'u bashkuar me liderin komunist Mao Ce Dun, zakonisht kish qejf ta mahniste pasagjerin e tij njëmbëdhjetë vjeçar me ato historitë e tij të stërzgjatura për truket dhe efektet kinematografike. Por sot as ai nuk po ia varte, duke e degdisur në ndenjësën e pasme. I binte fort burisë së fuqishme të veturës, në një duel të vazhdueshëm me kultitë agresivë të rikshave, të cilët mendonin se duke bllokuar rrugën, do arrinin të dëbonin makinat e huaja nga *Bubbling Well Road*. Jangu uli xhamin e dritares dhe nisi të fshikullonte me kamxhikun prej lëkure kalimtarët e hutuar,

vajzat e ngeshme të bareve me çanta amerikane, e amat plaka të thyera më dysh nën zgjedhën prej bambuje nga ku vareshin pula kokëprera.

Një kamion i hapur, i ngarkuar me xhelatë profesionistë, befasi manovroi përpara tyre, duke marrë rrugën drejt vendit ku kryheshin mbytyjet publike në Qytetin e Vjetër. Duke përfutur nga rasti, një lypsar i vogël këmbëzbathur nisi të vraponte përmbri *Packard*-it. I binte me grushte derës, duke i shtrirë dorën Xhimit, me atë thirrje tipike që e dëgjoje në çdo rrugë të Shangait:

- Jo mami! Jo babi! Jo uiski soda!

Jangu e goditi me kamxhik dhe çunaku ra përdhe, pastaj u çua sakaq midis rrotave të përparme të një veture *Chrysler* që po vinte pas tyre dhe zu të vraponte përmbri saj.

- Jo mami, jo babi...

Xhimi e urrente kamxhikun, po buria e *Packard*-it i pëlqente. Në mos tjetër, arrinte të mbyste rropamën e aeroplanëve gjuajtës tetëgrykësh, si dhe ulërimën e sirenavë të alarmit kundërajror të Londrës e të Varshavës. I kishte ardhur në majë të hundës me atë luftën në Europë. Xhimi vështroi fasadën me ngjyra të ndezura të një dyqani të *Sincere Company*, ku mbizotëronte një portret i stërmadh i Çan Kai Shekut, ku i bëhej thirrje popullit kinez për edhe më shumë sakrifica në luftën kundër japonezëve. Një dritë e mekët e një tubi difektoz neoni, drithëronte mbi buzët e buta të gjeneralisimit, e njëjta dridhje që ai kishte parë në ëndërr. I tërë Shangai po kthehej në një kinoditar, i projektuar nga brendësia e kokës së tij.

A mos i qe dëmtuar gjë truri nga aq shumë filma me luftë? Xhimi kishte provuar të fliste me nënën për ëndrrat e veta, mirëpo, ashtu si gjithë të rriturit në Shangai atë dimër, ajo kishte qenë tepër e shqetësuar dhe s'ia kishte venë fare veshin. Ndoshta dhe ajo shihte ëndrra të këqija. Por gjëja më shqetësuese ishte se këto pamje të shkartisura tankesh e bombarduesish në pikiatë ishin krejt të heshtura, a thua që mendja e tij që flinte përpiquej ta ndante luftën e vërtetë nga ato konfliktet e rreme të sajuara nga *Pathé* dhe *British Movietone*.

Xhimi nuk kish asnjë dyshim cila ishte e lufta e vërtetë. Lufta e vërtetë ishte gjithçka që ai kishte parë vetë qysh nga pushtimi japonez i Kinës më 1937: fushëbetejat e vjetra në Hungiao dhe Lunghua, ku çdo pranverë eshtrat e të vdekurve të pakallur shfaqeshin mes fushave të orizoreve. Të vërtetë ishin ata mijëra refugjatë kinezë që vdisnin nga kolera të mbyllur brenda kampeve të Potungut, si dhe kokat e përgjakura të ushtarëve komunistë të ngulura në hunj përgjatë Bundit. Në luftën e vërtetë, askush nuk e dinte me cilën palë qe dhe s'kishte as flamurë e as komentatorë apo fitimtarë. Në luftën e vërtetë s'kishte armiq.

Ndërsa konflikti i ardhshëm ndërmjet Anglisë dhe Japonisë, të cilin të gjithë në Shangai e prisnin të shpërthente në verën e 1942-shit, përkundrazi, i përkiste botës së thashethemeve. Tashmë barka e furnizimit e anijes gjerman në Detin e Kinës shkonte hapur në Shangai dhe ankoruhej në lumë, ku merrte karburant nga një duzinë maunesh - shumë prej të cilave, vinte në dukje me idhësi babai i Xhimit, u përkisnin kompanive amerikane të naftës. Pothuajse të gjitha gratë amerikane bashkë me fëmijët ishin evakuuar nga Shangai. Në klasën e tij, në Shkollën e Katedrales, Xhimi ishte i rrethuar nga bankat e zbrazëta. Shumica e shokëve të tij qenë larguar bashkë me nënat për në Hong Kong a Singapor, ndërsa baballarët e tyre i kishin mbyllur shtëpitë dhe vetë qenë vendosur në hotelet që qenë përgjatë Bundit.

Në të hyrë të dhjetorit, pasi dilte nga shkolla, Xhimi shkonte gjente të atin në tarracën e ndërtesës ku e kishte zyrën, në *Sechuan Road*, dhe e ndihmonte që të digjte arkat me

dokumente që nëpunësit kinezë i sillnin lart me ashensor. Copëzat e letrave të shkrumbuara ngriheshin lart përmes Bundit, ku vinin e përziheshin me tymin e oxhakëve të paduruar të avulloreve të fundit që largoheshin nga Shanghai. Korridoret e anijeve ishin të mbushura plot me udhëtarë: euroaziatikë, kinezë dhe europianë që luftonin kush e kush të hipte në anije me bohçet dhe valixhet e tyre, duke marrë në sy rrezikun e nëndetëseve gjermane që prisnin në grykën e Jancesë. Nëpër çatitë e ndërtesave të zyrave në distriktin financiar shiheshin zjarret e ndezur, që oficerët japonezë rrinin i vështronin me dylbi nga bunkerët prej betoni matanë lumit Potung. Ajo që e shqetësonte Xhimin më shumë nuk ishte zemërimi i japonezëve, po durimi i tyre.

Me të mbërritur në shtëpinë e tij në Bulevardin Amhërst, ai u ngjit me vrap sipër që të ndërrohej. Xhimit i pëlqenin papuçet persiane, këmisha e mëndafshtë me qëndisma dhe pantallonat e kaltra prej kadifeje që e bënë të dukej si ndonjë figurant në filmi *Hajduti i Bagdadit*, dhe nuk po i pritej sa të shkonte në festën e doktor Lokvudit. Do t'i duronte pehlivanët dhe kinoditarët, e pastaj do të nisej për në takimin e fshehtë ku për shkak të thashethemeve për luftën, kish muaj të tërë pa vajtur.

Për më tepër, që me fat që të dielën pasdite Vera e kishte pushim, për të shkuar te prindërit në geton e Honkjusë. Kjo vajzë, pothuajse fëmijë edhe vetë, mërzitej dhe zakonisht e ndiqte Xhimin kudo si qen roje. Kështu pra, pasi ta kthente Jangu në shtëpi - prindërit e tij do rrinin për darkë te Lokvudët, - ai do kishte mundësi të vërtitej sipas qejfit nëpër shtëpinë e zbrazët, që për të ishte kënaqësia më e madhe. Sigurisht, të nëntë shërbyesit kinezë do ishin aty, por në mendjen e Xhimit, ashtu si të çdo fëmije anglez, ata s'ishin veç ca figura po aq pasive dhe të verbër sa dhe orenditë. Do përfundonte së lyeri aeroplanit prej druri balsa, si dhe do mbaronte edhe një kapitull tjetër të manualit të titulluar *Si luhet brixhi*, të cilin po e shkruante në një fletore shkolle. Pas vitesh të tërë duke dëgjuar nënën tek luante brixh, duke u përpjekur të nxirrte ndonjëfarë logjike nga shprehje të tilla si "Një karo", "Pas", "Tre kupa", "Tre sanzatu", "Bellot", "Rebellot", ia kish mbushur mendjen asaj që t'ia mësonte rregullat dhe madje kishte arritur të zotëronte mënyrat e marrëveshjes, një kod brenda kodit, i atillë që gjithmonë i kish zgjuar kureshtje Xhimit. Me ndihmën e një udhëzuesi të Elli Kalberstonit, po gatitej të fillonte kapitullin më të vështirë nga të gjithë, kapitulli i hyrjeve psikike - dhe e gjithë kjo pa luajtur vetë as edhe një dorë.

Mirëpo, nëse kjo punë do bëhej tepër e lodhshme, do të bënte një shëtitje me biçikletë nëpër Koncesionin Francez, duke marrë me vete atë pushkën e tij pneumatike që ta kishte në rast se haste atë bandën e dymbëdhjetë vjeçarëve francezë të *Avenue Foch*. Kur të kthehej në shtëpi, do dëgjonte serialin radiofonik me *Flash Gordonin*, në kanalën XMHA, e pastaj programin muzikor të cilit ai dhe shokët e tij i telefononin për të bërë kërkesat e tyre, duke përdorur pseudonimet e tyre më të fundit - "Batman", "Bak Roxhers" dhe "Asi" (që ishte pseudonimi i tij, që i pëlqente ta dëgjonte kur e lexonte spikeri, ndonëse përherë e bënte të ndjehej mjaft në siklet.)

Pasi ia vërviti amës rason dhe veshi petkat e festës, kuptoi se të gjitha këto plane tashmë ishin të rrezikuara. E shqetësuar nga fjalët për luftën, Vera kish vendosur të mos shkonte për vizitë te prindërit.

- Do shkosh në festë, Xhejms, - i tha Vera duke ia kopsitur këmishën e mëndafshtë. - Kurse unë do t'u telefonoj prindërve që t'u them gjithçka për ty.

- Po ata... duan të të shohin, Vera. Duhet të mendosh për ta, Vera... - I hutuar, Xhimi ngurronte të ankohej. Nëna i kish thënë të tregohej i sjellshëm me Verën e të mos e ngacmonte siç kishte bërë me guvernanten e mëparshme. Ajo ruse e bardhë nursëze e kishte tmerruar kur po shërohej nga fruthi, duke i thënë se mund të dëgjonte zërin e Perëndisë në Bulevardin Amherst, që i paralajmëronte ata të bënin kujdes nga mëkatet. Pak kohë më pas, Xhimi i kish mahnitur shokët e shkollës kur kishte shpallur se ishte ateist. Vera Frankeli, perkundrazi, ishte një vajzë e qetë që nuk buzëqeshte kurrë, të cilës i dukej e çuditshme gjithçka që kishte të bënte me Xhimin dhe prindërit e tij; po aq e çuditshme sa vetë Shangai, ky qytet i dhunshëm dhe armiqësor, që e ndante një botë e tërë nga Krakovi. Ajo bashkë me prindërit e saj patën ikur me një nga anijet e fundit nga Europa e Hitlerit dhe tani banonin bashkë me njëmijë hebrenj të tjerë në Hongkju, një lagje e zyrtë shtëpish me qira dhe pallatesh të trishtë matanë zonës së portit të Shangait. Për habinë e Xhimit, Herr Frankeli dhe nëna e Verës jetonin në një dhomë të vetme.

- Vera, ku banojnë prindërit e tu? - Xhimi e dinte përgjigjen, por vendosi ta provonte një hile. - Në ndonjë shtëpi?

- Banojnë në një dhomë, Xhejms.

- Një dhomë! - Për Xhimin kjo ishte e papërfytyrueshme, ku e ku më e çuditshme se çfarëdolloj gjëje nga komikset e Supermenit dhe të Batmanit. - Sa e madhe është dhoma? Sa kjo dhoma ime? Sa kjo shtëpia?

- Sa garderoba jote. Ka njerëz, Xhejms, që nuk janë kaq me fat sa ty.

I impresionuar nga e gjithë kjo, Xhimi mbylli derën e garderobës dhe veshi pantallonat prej kadifeje. E mati me sy kthinën e vogël: E kishte po aq të vështirë të kuptonte se si mund të mbijetonin dy njerëz në një hapësirë aq të ngushtë, sa edhe marrëveshjet e brixhit. Ndoshta për ta zgjidhur këtë problem nevojitej ndonjë çelës i thjeshtë, gjë që mund të përbënte temën e një libri tjetër.

Për fat, krenaria e bëri Verën ta kafshonte karremin. Kur ajo u nis për vizitë te prindërit, duke përshkuar më këmbë një copë të mirë rrugë gjer te terminali i tramvajit në *Avenue Joffre*, Xhimi vazhdonte të bluante me mendje misterin e një dhome të vetme aq të jashtëzakonshme. Vendosi të diskutonte këtë çështje me prindërit, por ata, si gjithmonë, ishin aq të përhumbur nga lajmet e luftës sa që s'ia vunë fare veshin. Qenë veshur e bërë gati për të shkuar në festë dhe po rrinin në studion e babait, duke dëgjuar buletin radiofonik në valë të shkurtra nga Anglia. Babai po rrinte më gjunjë para radios dhe me atë veshjen e tij prej pirati, me fashën e zezë prej lëkure ngritur mbi ballë dhe gjyslyket mbi sytë e tij të lodhur, dukej si ndonjë pirat i shkolluar, që ia kishte ngulur sytë atij kuadrati të verdhë, të ngulur si ndonjë dhëmb i florinjte në fytyrën prej dru mogani të radios, ndërkohë që po shënonte në një hartë të Ruisë të hapur mbi qilim, vijën e re të mbrojtjes ku ishte tërhequr Ushtria e Kuqe. Pasi e shënoi, vazhdoi t'ia mbante sytë ngulur, me një pamje të pashpresë, po aq i çoroditur nga ajo hapësirë aq e madhe ruse sa ç'kishte qenë Xhimi nga dhoma e vockël e çiftit Frankel.

- Aty nga Krishtlindja, Hitleri do ketë mbërritur në Moskë. Gjermanët po vazhdojnë të përparojnë.

E ëma, me kostumin e saj si pierrot, po rrinte te dritarja dhe vështronte qiellin e çeliktë të dhjetorit. Mbi rrugë valëvitej bishti i gjatë i një balone mortore kineze, ndërkohë që koka e saj sikur po ia bënte me sy me një buzëqeshje të egër shtëpive europiane.

- Në Moskë duhet bjerë dëborë. Ndoshta moti do t'i pengojë...

- Një herë në çdo njëqind vjet? Edhe kjo do ishte të kërkoje tepër. Çurçilli duhet t'i fusë në luftë amerikanët.

- Babi, kush është Gjeneral Balta?

I ati ngrii sytë. Xhimi po rrinte më këmbë te dera, bashkë me amën e cila po i mbante pushkën pneumatike, si ndonjë mbartës armësh që, ashtu e veshur me kadife të kaltër, dukej si të qe pjesë e një trupe vullnetarësh të këmbësisë, gati për të mbështetur rusët në luftë.

- Jo pushkën me ajër, Xhejmi. Jo sot. Më mirë merr aeroplanin.

- Ama, mos e prek! Do të të vras!

- Xhejmi!

I ati u kthye, gati për t'i dhenë një shpullë. Xhimi ndenji pa folur pranë nënës, duke pritur se ç'do të ndodhte. Ndonëse i pëlqente të endej nëpër Shangai me biçikletë, kur qe në shtëpi, atij i pëlqente të rrinte përherë afër së ëmës, një grua e butë dhe e zgjuar që, sipas tij, kishte për qëllim kryesor në jetë të shkonte nëpër festa dhe ta ndihmonte atë për detyrat e latinishtes. Kur ajo s'qe në shtëpi, ai kalonte orë të tëra të qeta në dhomën e saj të gjumit, duke përzier parfumet e shfletuar ngeshëm albumet me fotografit e saja të para martesës, pamje të ngrira të një filmi magjik ku ajo luante për të rolin e motrës së tij.

- Xhejmi! Mos ta dëgjoj më ta thuash... Nuk do të vrasësh asnjëri, as amën, e askënd tjetër. - Babai i hapi grushtet dhe Xhimi kuptoi sa i lodhur ishte ai. Shpesh Xhimit i dukej se i ati e tepronte me përpjekjet e tij për të ruajtur qetësinë; në fakt, kishte një barrë të tërë me halle, që nga kërcënimet për firmën e tij nga ana e sindikatave komuniste, te puna që bënte për Shoqatën e Rezidentëve Britanikë, e deri tek frikërat që kishte për të, Xhimin dhe për nënën.

Teksa po dëgjonte lajmet nga lufta, Xhimi e ndjeu veten pothuajse të trullësuar. Mes prindërve të tij kish lindur një dhimbë e re që ai s'e kishte parë kurrë ndonjëherë më parë. Babai mund të qe i nxehur me të, por në të njëjtën kohë, tregohej aq shumë i interesuar për qoftë gjërat më të vogla të tij, a thua se mendonte se të ndihmonte të birin të ndërtonte modelin e aeroplanit kish më shumë rëndësi se sa vetë lufta. Për herë të parë, s'tregonte kurrëfarë interesi për rezultatet e tij në shkollë. Nga ana tjetër, i tregonte Xhimit gjithfarë gjërash të çuditshme - që nga kimia e ngjyrosjeve moderne, te plani i hollësishëm që kishte kompania e tij për asistencën sociale për punëtorët kinezë, apo shkollën dhe universitetin në Angli, ku do ta çonte Xhimin mbas luftës, dhe se si, po të donte, mund të bëhej mjek. Por të gjitha këto ishin elemente të një adoleshence që i ati dukej se e pranonte që nuk do vinte kurrë.

Xhimi vendosi se do bënte mirë të mos e ngacmonte, as të mos i fliste për dhomën e misterhme të familjes Frankel në geton e Hongkjusë, as për problemet e hyrjeve psikike, e as për ata filmat pa zë që kishte brenda kokës. Jo, s'do ta kërcënonte më asnjëherë amën. Rrugës për në festë, ai do përpiqej ta qetësonte babanë, duke gjetur ndonjë mënyrë se si t'i ndalonte gjermanët te portat e Moskës.

Duke kujtuar dëborën artificiale në studiot kinematografike të Shangait, siç ia kishte përshkruar Jangu, Xhimi zuri vend në *Packard*. U gëzua kur pa që Bulevardi Amhërst ishte plot me veturat e europianëve që po shkonin të festonin Krishtlindjet. Në të gjitha lagjet e perëndimorëve, njerëzit kishin veshur kostume të allasojta, a thua Shangai ishte bërë një qytet klounësh.



Bukinist

pasioni për librat